

Përshëndetje z. Ç.,

Në vijim të kërkesës suaj për informim, në kuadër të projektit rajonal WeBER 3.0, përsa i përket të dhënave që ju kërkoni, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju sqaron si vijon:

I. Referuar pikës së parë “Emërimet e drejtuesve të lartë” dhe pyetjeve në këtë pikë:

1. Numri aktual i drejtuesve të lartë që janë të emëruar në të gjitha institucionet e administratës shtetërore?
2. Sa prej tyre ishin me statusin nëpunës civilë para emërimit në detyrë si drejtues të lartë?
3. Dërgoni kopjet e 10 (dhjetë) akteve më të fundit të emërimit në detyrë për pozicione drejtuesi të lartë

Departamenti i Administratës Publike (DAP), referuar pikës 1 (f), të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. Sipas pikës 1 (a) të po këtij neni përcaktohet se “institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit.

Nga të dhënat e administruara rezulton se numri aktual i anëtarëve të trupës së nivelit të lartë drejtues të cilët janë emëruar në institucionet e administratës shtetërore është 77, ku prej tyre 74 janë të emëruar në pozicione të rregullt drejtues dhe 3 në pozicione të mesme drejtuese.

Nga 77 anëtarë të emëruar, 45 prej tyre kanë qenë pjesë e shërbimit civil përpara se të emëroheshin nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së,

Për sa i përket kërkesës suaj për t’ju vënë në dispozicion kopje të akteve të emërimit, ju bëjmë me dije se në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, përcaktohet se:

1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

a) të drejtën për një jetë private;

b) sekretin tregtar;

c) të drejtën e autorit;

ç) patentat

Për sa më sipër, në zbatim të gurmës "a", të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ku përcaktohet mundësia e kufizimit të drejtës së informimit për të mbrojtur të drejtën për një jetë private, DAP vlerëson se dhënia e informacionit në formën e kërkuar nga ana juaj do të cënonte këto të drejta, të palëve të treta.

Qëndrimi i DAP-it mbështetet dhe në nenin 3, të "KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR AKSESIN NË DOKUMENTE ZYRTARE Tromsø, 18.VI.2009", ratifikuar me Ligjin nr. 45/2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare". Në këtë dispozitë përcaktohet se:

"1. Secila Palë mund të kufizojë të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. Kufizimet duhet të përcaktohen saktësisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale, me synim mbrojtjen e: a) sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; b) sigurisë publike; c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes penale të veprimtarisë kriminale; d) hetimeve disiplinore; e) inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet publike; f) privatësisë dhe interesave të tjera legjitime private; g) interesave tregtare dhe interesave të tjerë ekonomikë; h) politikave ekonomike, monetare dhe valutore të shtetit; i) barazisë së palëve në procedimet gjyqësore dhe administrimit të efektshëm të drejtësisë; j) mjedisit; ose k) diskutimeve brenda apo ndërmjet autoriteteve publike në lidhje me shqyrtimin e një çështjeje. Shtetet e interesuara, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të deklarojnë se komunikimi me familjen mbretërore dhe oborrin e saj ose kreun e shtetit, duhet gjithashtu të përfshihet midis kufizimeve të mundshme.

2. Aksesit në informacionin në përmbajtje të një dokumenti zyrtar mund të refuzohet, nëse zbulimi i tij mund ose ka të ngjarë të dëmtojë interesat e përmendura në paragrafin 1, nëse nuk ka një interes publik më të lartë në lidhje me zbulimin e tij.

3. Palët duhet të marrin parasysh caktimin e afateve kohore pas të cilave kufizimet e përmendura në paragrafin 1 nuk zbatohen më."

Sjellim në vëmendjen tuaj se nëpunësit civilë nuk mund të privohen nga e drejta për një jetë private apo të drejta të tjera të përcaktuara në ligj. DAP në çdo përgjigje ndaj kërkesave për informim, detyrohet të balancojë si të drejtën për informim të kërkuar dhe të drejtat e personave të tretë që lidhen me informacionin e kërkuar, duke u përgjigjur në atë formë që nuk cënon asnjë nga këto interesa.

II. Referuar kërkesës së dytë: Raporti kandidat-vend vakancash në konkurset për drejtues të lartë" dhe pyetjet në këtë pikë:

Si fillim sqarojmë se në zbatim të neneve 27 dhe 29, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, procedura e pranimit në TND nuk zhvillohet për pozicione specifike, por për anëtarë të TND-së. Sqarojmë se procedura zhvillohet për grup pozicionesh dhe jo për pozicione specifike. Pozicioni në vetvete mbart karakter menaxherial dhe administrues. Anëtarët e TND-së mund të caktohen në çdo pozicion të rregullt të kategorisë së lartë drejtuese, të përcaktuar sipas pikës 4, të nenit 19, të këtij ligji, apo të caktohen koordinatorë të posaçëm.

Numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese, anëtarë të TND-së, është sa numri i pozicioneve të rregullta të kategorisë së lartë drejtuese ekzistuese në strukturat e miratuara apo të parashikuara për t'u miratuar brenda vitit buxhetor, në institucionet e administratës shtetërore, plus një rezervë prej 15 për qind e këtij numri. Gjithashtu numri i anëtarëve, që do të rekrutohen çdo vit, përcaktohet në planin vjetor të rekrutimit.

Për periudhën 1 qershor 2024-31 maj 2025, në zbatim të vendimit nr. 527, datë 1.8.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 63, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2024”, DAP shpalli procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND për 4 (katër) pozicione. Në këtë procedurë kishte 8 (tetë) kandidatë të kualifikuar për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit për Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues (TND), listën e të cilëve e gjeni në linkun:

https://www.dap.gov.al/images/tnd2024/2024_09_20_TND_Lista_Perfundimtare.pdf.

III. Referuar kërkesës së tretë “Emërimet në pozicione drejtues të lartë pa procedurë konkurruese”:

Në lidhje me këtë pikë të kërkesës për informacion, ju bëjmë me dije se, në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, plotësimi i një vendi të lirë të kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore bëhet vetëm me një anëtar të TND, pasi çdo emërim tjetër bie në kundërshtim flagrant me ligjin dhe konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.

Risjellim në vëmendjen tuaj se, në zbatim të kreut VII, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kandidatët e vlerësuar mbi pragun minimal të 70 pikëve, në procedurën e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, sipas radhës së renditjes dhe brenda numrit të miratuar të pranimit në TND brenda planit vjetor të pranimit, emërohen nga DAP nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND. DAP përpilon listën e anëtarëve të TND në pritje për t'u emëruar dhe ja përcjell Kryeministrit e ministrave të linjës.

Sipas kreut VI, pikat 3 dhe 4, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërimi i anëtarit të TND në një pozicion të rregullt apo në pozicionet koordinator i posaçëm, bëhet nga DAP pas administrimit të kërkesës së titullarit të institucioneve respektive:

- Kryeministri, për çdo pozicion të rregullt në Kryeministri apo në institucionet e varësisë së Kryeministrit;
- Ministri, për çdo pozicion të rregullt në ministri apo në institucionet e varësisë së ministrit;
- Kryeministri, zëvendëskryeministri apo ministrat respektivë, për pozicionet e koordinatorit të posaçëm në grupet institucionale apo ndërinstitutionale, ose në projekte të posaçme që janë nën përgjegjësinë e tyre.

Për sa më lart, një pozicion i kategorisë së nivelit të lartë drejtues në administratën shtetërore mund të plotësohet vetëm nga anëtarët aktualë të TND. Çdo emërim tjetër në këto pozicione i bërë në

kundërshtim me këtë parashikim ligjor, është absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Asnjë prej emërimeve të anëtarëve të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nuk kryhet pa zhvilluar procedurë konkurrimi.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 11, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Departamenti i Administratës Publike